



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL lidhur me nenin 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01 nr.016-28448 të datës 22.03.2018, si dhe lidhur me nenin 68 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenin 69 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 dhe nenin 25 paragrafi 6 dhe 8 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ, merr këtë:

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**PEZULLIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. Nëpunësi civil, Renan Imami i caktuar në detyra punuese Zyrtar për komunitete dhe mundësi të barabarta në kuadër të Zyrës për Komunitete dhe Kthim – Zyra e Kryetarit, pezullohet nga puna prej datës 09.01.2026 e deri në përfundim të mandatit përkatës.
2. Pas përfundimit të mandatit zgjedhor, zyrtarit publik i garantohet rikthimi në marrëdhënie pune në pozitën punuese të parapezullimit apo pozitë ekuivalente me të.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil, Renan Imami i caktuar në detyra punuese Zyrtar për komunitete dhe mundësi të barabarta në kuadër të Zyrës për Komunitete dhe Kthim – Zyra e Kryetarit, është zgjedhur asambleist i Kuvendit të Komunës dhe të njëjtit i pezullohet marrëdhënia e punës nga data 09.01.2026, pasi që i njëjti pas emërimit të kandidatit të zgjedhur nga asambleist në Nënkryetar për komunitete, sipas rradhës ka pranuar mandatin e asambelistit.

Kryetari i Komunës në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës në zbatim të nenit 68 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 69 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 dhe nenit 25 paragrafi 6 dhe 8 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Gjatë periudhës së pezullimit të marrëdhënies së punës, nëpunësit civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në KPMSHCK në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**  
-Nëpunësit civil



Zyra e Kryetarit | Komuna e Gjilanit  
Rr. Bulevardi "Ibrahim Rugova" PN | Gjilan 60000 | Republika e Kosovës  
Tel: +381 280 320 781 | <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> | [alban.hyseni@rks-gov.net](mailto:alban.hyseni@rks-gov.net)